



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI QARKUT
TIRANË

-

**SHPLLJE PËR LEVIZJE PARALELE
NGRITJE NË DETYRË
NË KATEGORINË E MESME DHE TË ULËT DREJTUESE**

Në zbatim të nenit 26 të ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), si dhe të Kreut II, III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, (i ndryshuar) të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Qarkut Tiranë shpall procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për pozicionin:

- **Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Zhvillimit të Projekteve në Këshillin e Qarkut Tiranë Kategoria II-b**

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE

7 shkurt 2020

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

NGRITJE NË DETYRË

12 shkurt 2020

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Zhvillimit të Projekteve është përgjegjës për koordinimin e politikave efektive të lidhura me funksionet e institucionit, të koordinimit me institucionet e nivelit të parë të qeverisjes vendore pjesë e qarkut Tiranë, institucionet qendrore sipas fushave të kompetencës institucionale që lidhen me funksionet e qarkut, partnerët e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare sipas projekteve me interes të përbashkët të hartuara me to, mirëadministrimin dhe sigurimin e vlerave financiare dhe materiale të institucionit duke siguruar përdorimin efektiv të fondeve buxhetore në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, është nëpunës zbatues për institucionin dhe përgjegjës për zbatimin e rregullave që lidhen me menaxhimin financiar, kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, si dhe përgjigjet para nëpunësit autorizues. Gjithashtu udhëheq procesin e hartimit të planit buxhetor afatmesëm dhe vjetor (parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve), mbështetur në prioritetet dhe objektivat e institucionit, si dhe përgatit të gjitha ndryshimet e tij gjatë vitit; përgatit të gjitha informacionet në lidhje me situatën financiare të institucionit, realizimin e shërbimeve dhe investimeve etj., bashkëpunon në hartimin e projekt-vendimeve që mbartin efekte financiare; garanton zbatimin e politikave nacionale të pagave, parashikimin dhe llogaritjen e fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për administratën; monitoron shpenzimet buxhetore mbi bazën e produkteve dhe vlerëson zbatimin e politikave buxhetore të Institucionit në përputhje me legjislacionin në fuqi; përgatit pasqyrat financiare të njësisë në përputhje me rregullat e miratuara nga ministria e financës si dhe bilancet periodike dhe vjetore dhe ja paraqet për shqyrtim dhe miratim titullarit të institucionit. Mirëadministron dokumentacionin financiar që krijohet gjatë vitit ushtrimor në mbështje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

I- LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori II-b;
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Ekonomike/ Financë-Kontabilitet, dhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- të kenë mbi 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion;
- c- të kenë njohuri shumë të mira të akteve ligjore dhe nënligjore të organizimit dhe funksionimit të organeve të vetëqeverisjes vendore, aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, zhvilluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve, aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi.
- d- të kenë njohuri të një gjuhe të BE.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrim-standard>.
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor) Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njëhësisht nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dorëzimi i dokumentave për lëvizjen paralele duhet të bëhet me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion (Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore – Këshilli i Qarkut Tiranë/ Sheshi “Mustafa Kemal Atatürk” Tiranë), brenda datës **07.02.2020.**

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **10.02.2020** Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të lëvizjes paralele si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të procedurës së lëvizjes paralele do të njoftohen individualisht nga Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore të Këshillit të Qarkut Tiranë, në mënyrë elektronike, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
- b- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

- d- Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar);
- e- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar);
- f- Njohuritë mbi Ligjin Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- g- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar);
- h- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar);
- i- Njohuritë mbi Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (i ndryshuar).

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerezore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të internetit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerezore për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2- NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në “Portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Qarkut Tiranë, duke filluar nga data 21.02.2020.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë III-a ose III-b;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Ekonomike/Financë-Kontabël, dhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- të kenë mbi 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion;
- c- të kenë njohuri shumë të mira të akteve ligjore dhe nënligjore të organizimit dhe funksionimit të organeve të vetëqeverisjes vendore, aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, zhvilluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve, aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi.
- d- të kenë njohuri të një gjuhe të BE.

2.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrim-standard>.
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor) Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehësimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

Sheshi “Mustafa Qemal Atatürk”.Tiranë, Shqipëri, tel: +355 4 22 51 41 , Fax.: +355 4 22 38 90 krvetari@qarkutirane.gov.al

- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dorëzimi i dokumentave për ngritjen në detyrë duhet të bëhet me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion (Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore – Këshilli i Qarkut Tiranë/ Sheshi “Mustafa Kemal Atatürk” Tiranë), brenda datës **12.02.2020.**

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Duke filluar nga data **21.02.2020**, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria Juridike, dhe Burimeve Njerëzore të Këshillit të Qarkut Tiranë, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
- b- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- d- Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar);
- e- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqipërisë” (i ndryshuar);
- f- Njohuritë mbi Ligjin Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- g- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar);
- h- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar);
- i- Njohuritë mbi Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (i ndryshuar).

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në **40 pikë**;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në **40 pikë**;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në **20 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të internetit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë do të marrin informacion në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Qarkut Tiranë si dhe numër telefononi në 042225141 ose në adresën: Këshilli i Qarkut Tirane “Sheshi Mustafa Kemal Atatürk” , për fazat e mëtejshme të kesaj procedure:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- Për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Qarkut Tirane si dhe numër telefononi në 042225141 ose në adresën: Këshilli i Qarkut Tiranë “Sheshi Mustafa Kemal Atatürk” duke filluar nga data 21.02.2020.

